



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.185/2 prot:

Pukë, më 16.02.2024

VENDIM

Nr 02 date 09.02.2024

**“ MIRATIMIN E KRITEREVE SPECIFIKE PËR FONDIN 6% TË NDIHMËS
EKONOMIKE PËR VITIN 2024”**

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”, Ligji Nr.57/2019, date. 18.07.2019 “Për Asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në VKM nr.597 date 04.09.2019 ”Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”si dhe bazuar në Udhëzimin Nr.5 datë 17.02.2017,”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” :

VENDOSI:

Miratimin e Kriterëve Specifike për vitin 2024 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës së pikëzimit.

- 1-Familje të varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, që nuk plotësojnë nevojat bazë për jetesë.
- 2-Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare më aftësi të kufizuar/invalid pune.
- 3-Familje me shumë fëmijë.
- 4-Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme.
- 5-Familje me k/familjare femra me të ardhura të pamjaftueshme,dhe probleme sociale.
- 6-Persona që jetojnë të vetëm ,të moshuar apo dhe të rinj me probleme social ekonomike.
- 7-Familje me të ardhura të pamjaftueshme që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.
- 8-Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.
- 9-Familje që kanë në përbërje të moshuar,që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.
- 10-Kryefamiljare të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Ndihmës Ekonomike

Shpallur me date 16.02.2024

Miratuar me 9 vota pro,Vota Pro 9, Vota Kunder 0 , Vota Abstenim 0 .

SEKRETARE

Edona **HYSENAJ**

KRYETARI I KESHILLIT

Eduard **GJOKA**



ser. KAMM/A
2 y. Edon, '
Loni

27.07.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

185/4
26.02.2024
REPUBLICA E SHQIPËRI
SEKRE
BASHK

Nr. 171/1 prot.

Shkodër më 22.02.2024

Lënda: Mbi Vendimin nr. 2, datë 09.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Pukë

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 24, neni 54, shkronja "n", neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu IV, pika 1, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, dt. 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", i ndryshuar, *shqyrtoi VKB Pukë nr. 2, datë 09.02.2024 "Mbi miratimin e kriterëve specifike për fondin 6% të ndihmës ekonomike për vitin 2023"*.

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

